




Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo



ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRAÇANICA

Në bazë të nenit 43 dhe nenit 47 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 5 të Udhëzimit administrativ nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të komunës, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës thërret mbledhjen e rregullt dhe dërgon:

FTESË

I/e nderuar,

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e katërt të rregullt të Kuvendit Komunal të Graçanicës, e cila do të mbahet të mërkurën më datën 26.08.2026. Mbledhja do të fillojë në orën 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit, kati i parë nr. 2.11 në objektin e Komunës së Graçanicës në Graçanicë. Të bashkëngjitur me ftesë gjeni rendin e ditës dhe materialin për këtë mbledhje.

Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e rregullt, e mbajtur më datën 26.06.2026.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komunës së Graçanicës për periudhën 01.01.2026-30.06.2026, me propozim të kryetarit të Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq (*Novak Živić*).
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për fillimin e procedurës së shpronësimit të tokës për zgjerimin e varrezave në Gushtericën e Poshtme, me propozim të kryetarit të Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq (*Novak Živić*).
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit gjashtëmuor financiar për periudhën janar-korrik 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq (*Slaviša Ničić*).
5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare vjetore të Komunës së Graçanicës për vitin 2025 dhe Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për themelimin e Komisionit të Kuvendit të komunës për zgjedhjen e Këshillave lokale, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq (*Milan Dimitrijević*).
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Deklaratës për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq (*Milan Dimitrijević*).
8. Informata për përfundimin e vitit shkollor 2025/2026, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq (*Brankica Ničić*).
9. Të ndryshme.

Kryesuesi i KK të Graçanicës

Milan Dimitrijević

